

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-098/2015

**Prishtinë,
20 shtator 2017**

Në çështjen juridike të:

G. V.

Pala ankuese

Kundër

Askush

Pala Përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronave i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA90212), të datës 30 Prill 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 20 shtator 2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet si jo e plotë ankesa e G. V. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014, të datës 30 Prill 2014 lidhur me Kërkesën KPA90212.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 30 Dhjetor 2008, G. V.ć (më tej pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku pretendon pronësinë e ngastrave kadastrale Nr 131/6 me sipërfaqe prej 01.00.00 ha dhe ngastrës Nr 61 me sipërfaqe prej 02.67.07 ha e cila gjendet në zonën kadastrale të Sllatinës. Pala pretendon se prona e tij është zënë nga Aeroporti civil i Sllatinës dhe tani ai kërkon kompensimin për shfrytëzim pa lejen e tij dhe kthimin e posedimit.
2. Së bashku me kërkesën pala ankuese kishte dorëzuar në AKP:
 - Aktgjykimin P.br.41/92 të datës 3 shkurt 1993 me të cilin ndërmarrja “Poljopriovreda” obligohej që t’ia kthente në posedim palës ankuese ngastrën 131/6, pasi me aktgjykimin e njëjte anulohet kontrata e lidhur ne vitin 1958;
 - Aktgjykimin P.br.423/93 i datës 20 Tetor 1994 me të cilin ndërmarrja “Poljopriovreda” obligohej që t’ia kthente në posedim palës ankuese ngastrën 61,pasi me aktgjykimin e njëjte anulohet kontrata e lidhur ne vitin 1958;
 - Përshkrimin e fletës poseduese Nr.100 që dëshmon se në zyrën kadastrale në Lipjan prona e kërkuar ishte e evidentuar si pronë shoqërore e Kooperativës Bujqësore “Kosova”.
3. Identifikimi i pronës së kërkuar ishte bërë më 22 Korrik 2010 dhe ishte konfirmuar me 15 Janar 2014 duke shfrytëzuar të dhënat kadastrale dhe bazuar në Ortophoto-n dhe koordinatat e GPS-it. Njoftimi i kërkesës ishte publikuar në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së, Nr. 5 dhe ishte afishuar në Gjykatën komunale në Lipjan, zyra e UNHCR-së etj.
4. Sipas raportit të verifikimit dokumentet e dorëzuara-aktgjykimet ishin gjetur dhe verifikuar pozitivisht kurse sipas detyrës zyrtare AKP-ja kishte gjetur certifikatat e pronësisë që dëshmonin se prona e kërkuar evidentohej në emër të peronave të tretë M. dhe A. B. por

mungonin të dhënat se si ka ardhur deri te ndryshimi në regjistrat kadastrale. Dhe në të dhënat kadastrale në Drejtorinë për kadaster dhe Gjeodezi të Lipjanit të administruar nga UNMIK-u lista posedues e nr.328 tregon se ngastra kadastrale 61 me sipërfaqe prej 3.67.01 h është e evidentuar në emër të M. dhe A. B. në pjesë prej ½ të pronësisë. Kjo fletë poseduese dëshmon se është azhurnuar në muajin e 12 të vitit 1996.

5. Më 30 Prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), me vendimin e saj KPCC/D/R/236/2014 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i KKPK-së) kishte hedhë poshtë kërkesën dhe në arsyetimin e tij në paragrafin 18 theksohet se paraqitësi i kërkesës në këtë rast pala ankuese nuk e ka humbur posedimin si rezultat i konfliktit por si pasojë e një transaksioni joformal.
6. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 17 Tetor 2014. Më 14 Nëntor 2014 pala ankuese ka paraqitur një kërkesë të shoqëruar me një padi me të cilën kërkon nga AKP-ja dhe Zyra kadastrale në Lipjan regjistrimin e pronës sipas aktgjykimit të formës së prerë.
7. Përkundër faktit se G. V. nuk e emëron si ankesë AKP-ja i ka përcjellë Gjykatës Supreme me 15 Prill 2015 duke e trajtuar si ankesë me referencë përkatëse. Në këtë shkresë pala nuk atakonte në asnjë pjesë Vendimin e KKPK-së e as që deklaronte ndonjë pretendim për shkelje të ligjit material apo atij procedural. Pala ankuese kërkon nga AKP-ja dhe Zyra kadastrale e Kosovës që të zbatohen aktgjykimet e formës së prerë dhe prona e kërkuar të regjistrohej në emër të tij.
8. Gjykata Supreme me 28 Mars 2017 në kuptim të nenit 179.1 të Ligjit nr. 03/L-079 mbi Procedurën Kontestimore duke gjetur se ankesa nuk i përmban elementet e parapara në nenin 178 të Ligjit nr. 03/L-079 mbi Procedurën Kontestimore i ka dërguar shkresë dhe ka kërkuar nga AKP-ja që ankesa në afatin ligjor të sillet në Gjykatë ose e njëjta të plotësohet.
9. Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se edhe pas kalimit të afatit të caktuar ankesa nuk është plotësuar. Për këtë arsye e ka hedhë si jo të plotë.

Konstatim

10. Gjykata Supreme e ka bazuar vendimin e vet në dispozitat e nenit 178 të LPK-së ku parashihet se *“Ankesa duhet të përmbajë: a) tregimin e aktgjykimit kundër të cilit paraqitet ankimi; b) deklaratën se aktgjykimi kundërshtohet në tërësi ose në pjesën e caktuar; c) shkaqet e ankimit me arsyetim; d) nënshkrimin e paraqitësit të ankimit”*. Pra ankesa jo e

plotë dhe e pa plotësuar sipas afatit të caktuar është hedhur siq parashihet në nenin 179.2 të Ligjit nr. 03/L-079 mbi Procedurën Kontestimore e ndërlidhur me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

11. Gjykata ka hedhur ankesën si të pa plotësuar dhe nuk ka vendosur për meritat, kështu që ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për palët e as që paraqet pengesë për inicim të procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente.
12. Duke u bazuar në atë që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafi 1(d) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, u vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam , Referent i EULEX-it